



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 janar 2026

Në mbështetje të nenit 13 (Këshilltarët Juridik) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, bazuar në rregullin 22 (Njësia Ligjore e Gjykatës Kushtetuese) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 2 (Funksionet e Njesisë Ligjore), nenin 6 (Funksionet e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridik), nenit 7 (Funksionet e Këshilltarit Kushtetues Juridik) nenin 11 (Rekrutimi) dhe nenin 12 (Fillimi i rekrutimit) të Rregullores nr.03/2019 të Njesisë Ligjore, Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese shpall:

**KONKURS
për plotësimin e 3 (tri) vendeve të punës**

1.

Pozita:	Këshilltar/e i/e Lartë Kushtetues/e Juridik/e
Kodi:	GJ-DL-04-12
Numri i vendeve të punës:	2 (dy)
Klasa:	O3
Kohëzgjatja e emërimit:	Pa afat
Puna provuese:	1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Nën mbikëqyrje të Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik dhe të gjyqtarëve përkatës, mbështet punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza, dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike, të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- ndihmon në përgatitjen e raporteve paraprake, vendimeve dhe materialeve të tjera ligjore që ndërlidhen me juridiksionin e Gjykatës;
- bën analiza kushtetuese dhe ligjore;
- merr pjesë në seanca shqyrtuese dhe mban shënime për rastet;
- përgatitë opinione kushtetuese-ligjore sipas kërkesave të Kryetarit apo gjyqtarëve të Gjykatës;
- monitoron dhe udhëzon Këshilltarët Kushtetues Juridikë lidhur me detyrat që u janë caktuar atyre në rastet;
- kontribuon në funksionimin efikas dhe efektiv të Njesisë Ligjore si dhe kryen detyra tjera që kërkojnë nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik;
- përgjegjës për të siguruar kualitetin e vendimeve të Gjykatës në rastet në të cilat janë caktuar; dhe
- përgjegjës për të mbështetë hulumtimin, analizën dhe hartimin e mendimeve mospajtuese dhe konkurruese sipas këshillës së gjyqtarit.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme

- përgatitje e avancuar universitare në shkencat juridike, me ekspertizë në të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, të drejtësisë kushtetuese dhe të drejtat e njeriut;
- pesë (5) vite përvojë profesionale juridike;
- njohuri të shkëlqyeshme të angleze.

2.

Pozita:	Këshilltar/e Kushtetues/e Juridik/e
Kodi:	GJ-DL-13-17
Numri i vendeve të punës:	1 (një)
Klasa:	O4
Kohëzgjatja e emërimit:	Pa afat
Puna provuese:	1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Nën mbikëqyrjen e këshilltarit të Parë kushtetues juridik, mbështet punën profesionale të këshilltarëve juridikë të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime dhe analiza për aspekte të ndryshme ligjore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- a) mbështetë punën e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë;
- b) hulumton dhe studion literaturë përkatëse kushtetuese – ligjore të nivelit vendor dhe ndërkombëtar;
- c) hulumton dhe kërkon informacion të nevojshëm, *inter alia*, të vendimeve të gjykatave të tjera kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- d) përgatitë analiza krahasuese në bashkërendim me Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë;
- e) kontribuon në funksionimin efektiv dhe efikas të Njësisë Ligjore, si dhe kryen punë tjera që kërkohen nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme

- përgatitje universitare në shkencat juridike, preferohet ekspertizë në të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, të drejtësisë kushtetuese dhe të drejtat e njeriut;
- tri (3) vite përvojë profesionale juridike;
- njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Informata të përgjithshme për kandidatët

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin publik të Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin formularin e aplikimit, të shoqëruar nga një jetëshkrim (CV), një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës i cili dëshmon përgatitjen shkollore dhe përvojën e kërkuar të punës, si dhe përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe atyre të veçanta për pozitën e shpallur.

Formulari i aplikimit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org. Aplikacionet e dorëzuara pa formularin zyrtar refuzohen.

Aplikacioni me të gjitha dokumentet e kërkuara mund të dorëzohet nëpërmjet emailit në adresën: gjk.burimetnjerëzore@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Adresa: *Perandori Justinian 44, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës*).

Konkursi mbetet i hapur tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës si dhe shpalljes publike, duke filluar nga data 14.01.2026 deri më datën 12.02.2026.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 12/02/2026, deri në orën 16:00.

Shënim: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe jo të plota refuzohen.